



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:007136

Datë: 21.01.2020

Numri i dokumentit: 00786389

P.nr.1005/2015

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - departamenti i përgjithshëm divizioni penal. si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga gjyqtari individual Adem Shabani me zyrtares ligjore Kadishe Shabani, në çështjen penale kundër të pandehurit F.B, nga fshati ... Komuna, Ferizaj, për shkak të veprës penale vjedhja pylli nga neni 358 par.2 KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/IL.nr.2898-1/14 të 20.08.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt.21.01.2020, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Avdullah Abedini të pandehurit, F.B të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **F.B**, nga Fshati ..., Komuna, Ferizaj, i lindur më ..., në të njëjtin vend nga i ati E... dhe e ëma H..., e gjinisë C..., i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, , me nr. Personal ..., mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datën 05.12.2014, rreth orës 16:02, në pyllin publik, në vendin e quajtur, ” L...”, në Rajonin Ekonomiko Pyjor-Nerodime- Jezercë, i pandehuri me qëllim të përfitimit pasuror në mënyrë të kundërligjshme për vete apo personin tjetër me sharrë motorike ka prerë dy cope trungje masë drurore të llojit Ahu me diametër 58-49 cm dhe gjatësi 29 m me vëllim të përgjithshëm prej 6,36 metra kub, të njëjtat i kishte transportuar me traktor, me të cilin veprim ka dëmtuar Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari (DPB) në Ferizaj në vlerë prej 858,60 Euro,-

-me të cilën kreu veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 41, 46, 49, 50, 51, dhe 73 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së të akuzuarin e

G J Y K O N

Të pandehurit F.B, i shqipton:

- dënimin me gjobë në shumë prej 100 / njëqind / Euro, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan në periudhë prej dy muajsh, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe

- dënim me kusht me burg prej 4 / katër / muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehura në afatin prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprën tjetër penale.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burgim.

Obligohet i pandehuri që Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik Komuna e Ferizajt ti kompensojë dëmin e shkaktuar në shumën prej 858,60 Euro.

Obligohet i pandehuri të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej nga 20 (njëzetë) Euro, dhe taksën në shumën prej 30 Euro, komfor nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.2898-1/14 të 20.08.2015, të pandehurin F.B, nga fshati ... Komuna, Ferizaj, për shkak të veprës penale vjedhja pylli nga neni 358 par.2 KPRK-së për veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar më dt. 21.01.2020, në prezencën e prokurorit të shtetit Avdulla Abedini, Përfaqësuesit të DBP-së në ferizaj L.J dhe të pandehurit F.B i cili është siguruar sipas urdhëresës nga Policia e Stacionit Policor në Ferizaj.

Në fillim të shqyrtimit fillestar prokurori i shteti bazuar në fletëparaqitjen e rojes së pyllit dhe procesverbalit të komisionit të vlerësimit të demit tek të dhënat personale në aktakuzë është shkruar F.E emri i babës kurse duhet të jetë mbiemri B... kurse pjesët tjera të aktit akuzues mbetën të pa ndryshuara.

I pandehuri F.B është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të pandehurit janë përfill, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën të pandehurit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I pandehuri F.B, ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar si në dispozitiv të akuzës dhe se e vërtet se ka shkuar në pyll me traktor dhe drutë i ka prerë për nevoja të tij familjare pasi gjendjen ekonomike e ka jo të mirë, i pa punë mbajtës i familjes, i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal të merr për bazë pranimin e fajit dhe gjendjen e tij ekonomike.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë, mbrojtësit dhe të dëmtuarit.

Prokurori shtetit Avdullah Abedini, ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtor pasi pranimin e fajësisë e ka mbështetur në provat që gjinden në shkresat e kësaj lënde penale.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar se i pandehuri pranimin e fajësisë e ka mbështet në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale në procesverbalin dhe fletëparaqitjen e rojës së pyllit nr.462/2014 e dt.12.12.2014 ,procesverbalit të eksperteve të vlerësimit të demit të pylltarisë nr.462/2014 datës 11.12.2014.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjithë elementet e veprës penale vjedhja pylli nga neni 358 par.2 KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit nenit 73 të KPPK-së, si rrethana lehtësuese gjykata mori pranimin e fajësisë, gjendjen e varfër të akuzuarit, i pa punë, si dhe rrethanat e tij familjare, se është i gjendjes së dobët ekonomike, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata mori se kohëve të fundit me të madhe janë duke u dëmtuar pyjet shoqërore. Në bazë të këtyre rrethanave gjykata i caktoj dënim si në dispozitiv të aktgjykimit, duke qenë e bindur se një dënim i tillë është plotësisht i justifikueshëm dhe në proporcion me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetit e të pandehurit, dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari në të ardhmen të mos kryejë vepra penale, si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të përgjithshëm të kësaj veprë penale në shoqëri shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Gjykata duke u mbështetur në nenin 463 par.2 të KPPK-së ka obliguar të pandehurin lidhur me dëmin që i ka shkaktuar Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari(DPB) në Ferizaj ti kompensoj në vlerë prej 858,60 Euro, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e viktimave të krimit Nr.05/L-036.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,

P.nr.1005/2015 me datë 21.01.2020

Zyrtare ligjore

Kadishe Shabani

Gjyqtari

Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.